



Tiranë, 08 Shkurt 2019
Nr. Prot 28

VENDIM

për Kriteret e pranimit në Akademinë e Filmit dhe Multimedias Marubi për vitin akademik 2020-2021

Pranimi në AFMM bëhet në dy etapa.

I. Aplikimi për konkursin e pranimit në Akademinë e Filmit dhe Multimedias Marubi bëhet me depozitim të dosjes së aplikimit, e cila përmban:

- Formularin e regjistrimit të plotësuar dhe të firmosur
- një Curriculum Vitae (Jetëshkrim),
- Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave; ose Dëftesën e shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, të njehsuar dhe ekuivalentuar nga MASR në Shqipëri; ose dëftesë pjekurie të shkollës së mesme (kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011); si edhe certifikatën përkatëse, të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Provimeve;
- 2 fotografi,
- një kopje dokumenti identifikimi (letërnjoftim ose pasaportë),
- dhe në rast se ka, certifikatë i gjuhës së huaj.

II. Mbas plotësimit të dosjes, kandidatët pranohen në konkursin e pranimit i cili zhvillohet në tre faza përpara komisionit të pranimit në AFMM:

- test për kulturën e përgjithshme (me gojë),
- test për kulturën kinematografike (me shkrim),
- një ushtrim fotografik me 3 foto/story.
- Gjithashtu testohet gjuha të cilën kandidati pretendon se zotëron, në rast mungese të certifikatës.

Gjithashtu, përveç plotësimit të dokumentacionit dhe vlerësimit në konkursin e organizuar nga Akademia Marubi, kriteri i parë është mesatarja minimale e vendosur sipas VKM për regjistrimet në Institucionet e Arsimit të Lartë.

Këshilli i AFMM

Kujtim Gashi

Robert Malin

Luljeta Haxhi

